



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 48
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204.
Prishtinë, më 24 janar 2017, në orën 11:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nehat Baftiu, Fikrim Damka, Fadil Beka, Besa Baftiu, Ali Berisha dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Hatim Baxhaku, Mirjeta Kalludra dhe Adem Hoxha.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Nehat Baftiu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16.12.2016, 29.12.2016 dhe 30.12.2016;
3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2016;
4. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017;
5. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit, Nehat Baftiu, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më : 16.12.2016, 29.12.2016 dhe 30.12.2016;

3. Kryetari, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të komisionit, të mbajtura më 16.12.2016, 29.12.2016 dhe 30.12.2016.

4. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2016;

Kryetari- Po vazhdojmë me shqyrtimin e Raportit të punës së Komisionit për vitin 2016. Unë s'kam diçka për të shtuar pasi që unë kamë udhëhequr vetëm dy mbledhjet e fundit të Komisionit dhe nëse ka dikush për të shtuar.

Besa Baftiu -Ne e kemi shqyrtuar raportin e punës për vitin 2016. Në bazë të asaj që kemi vërejtur, fatkeqësisht nuk e kemi përmbushur planin e punës për këtë vit për arsye se Qeveria nuk i ka proceduar ligjet të cilat kanë qenë të parapara me programin legjislativ për vitin 2016. Kjo është papërgjegjësi e Qeverisë, e cila nuk ka plan të punës, por punon me plane ad hoc aty për aty. Pra, nuk i ka proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend ligjet, siç kanë qenë të parapara kurse ligjet shumë të rëndësishme, siç janë Ligji për Buxhetin dhe Veteranët e UÇK-së i ka proceduar brenda ditës për miratim. Në këtë rast shprehu shqetësimin tim lidhur me atë që ka ndodhur në seancën kur është shqyrtuar Projektligji për Veteranët e UÇK-së, ku kryetari i OVL të UÇK- së ka fyer dhe kërcënuar deputeten Aida Derguti. Pra unë s'kam qenë në mbledhjen e Komisionit kur e keni shqyrtuar këtë projektligj, mirëpo së paku është dashtë që ju si komision apo si kryetar i komisionit të kërkoni nga kryetari i OVL të UÇK-së që të kërkojë falje për fyerjet apo kërcënimet ndaj deputetes Aida Dërguti sepse nuk është vetëm deputete e Lëvizjes por është edhe nënkryetare e Kuvendit. Pra, krejt në fund po theksoj se kjo Qeveri është pa plan, pa program qeverisës.

Shukrije Bytyçi - Sa i përket planit të punës unë kame vërejtje te Ministria e Shëndetësisë, pra ne jemi takuar disa herë me ministrin, mirëpo nuk është e mjaftueshme t'i mbajmë vetëm takimet dhe marrjen rekomandimeve e që të mos punohet asgjë. Vërejtje kemi në këtë rast te raportet e auditimit, vërejtjet behën zakonisht pothuajse të njëjtat dhe nuk merren asnjë masë.

Po ashtu, te monitorimi i ligjeve dalin rekomandimet, pra nuk merren masa në adresimin e rekomandimeve. Në këtë rast ne do të japim kontributin në përgatitjen e planit të punës për vitin 2017 dhe të kemi një situatë më të mirë.

Ali Berisha- Komisioni për shëndetësi e ka kryer një punë gjatë vitit të kaluar, pamundësia e ndikimit e komisionit në përmirësim të shëndetësisë sidomos ka qenë minimale. Ato çka janë diskutuar apo ka pasur dakordim në Komision për shtyrje, qoftë në nivel Kuvendi apo të Qeverisë, pra nuk ka mundur që t'i shtyjë. Do të ndalem në disa çështje të cilat kanë qenë çështje të diskutimit në vitin e kaluar dhe janë trajtuar në Komision, mirëpo implementimi i atyre qëndrimeve të komisionit të papërfillshme. Ne e kemi diskutuar çështjen e specializantëve. Kemi pasur shumë takime edhe me qeverinë edhe me specializantët dhe ende ka probleme në këtë drejtim.

Është diskutuar edhe në Komision se Shëndetësia nga Qeveria nuk ka qenë në prioritet, kjo sidomos në aspektin financiar, pra edhe kur është trajtuar çështja e buxhetit, kemi pasur shumë vërejtje, si për ndarjet buxhetore, për mundësinë e rritjes së mbështetjes në aspektin buxhetor dhe pothuajse asnjëra nuk është trajtuar nga ministria dhe Kuvendi.

Në procesin e monitorimit të institucioneve shëndetësore, që e kemi bërë si komision dhe në shumicën e institucioneve ato që janë vërejtore në moszbatimin e Ligjit të Shëndetësisë, nuk janë

marrë parasysh, pra njëra prej problemeve të mëdha është mungesa e stafit shëndetësor. Pra, edhe për vitin 2017 nuk do të kemi një përmirësim, pasi që nuk janë trajtuar këto probleme.

Po ashtu, edhe Ligji për Veteranët e UÇK-së ka pasur vërejtje të shumta, diskutime dhe pothuajse ato që kanë qenë sugjerimet e komisionit nuk janë trajtuar dhe në këtë vit që po hymë, të kemi një koordinim sa më të mirë me qëllim që diskutimet apo rekomandimet e komisionit në implementim të ligjeve dhe mbështetjes në shëndetësi, çështjet sociale, të jetë ndikimi me i madh yni.

Fikrim Damka- Pasi që nuk është prezentë ish-kryetarja e Komisionit znj. Flora Brovina, për të prezantuar në detaje punën e Komisionit për vitin 2016, do të sqarojë disa çështje, lidhur më punën e komisionit që e ka pasur për këtë vit. Komisioni në bazë të mandatit dhe fushëveprimit që ka pasur, mendoj që e ka kryer obligimin e vetë sa i përket shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve. Ajo që ka pasur mungesa në procedimin nga Qeveria nuk është obligim yni.

Po ashtu, Komisionin kur ka filluar që të punojë, ka filluar me një mungesë të deputetëve, pra kanë marrë pjesë vetëm pesë deputetë, ku shpeshherë kemi qenë vetëm katër deputetë, mirëpo punën s'e kemi ndalur si në monitorimin dhe hartimin e legjislacionit.

Një nga sukseset më të mëdha të Komisionit ka qenë shqyrtimi i Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent, ku e kemi ndryshuar pothuajse komplet Ligjin për shërbimin mjekësor emergjent.

Nuk mund të themi se Komisioni s'ka pasur ndikim në përmirësimin e sektorit të shëndetësisë. Ne si komision kemi dhënë angazhimin maksimal për të ndryshuar apo përmirësuar gjendjen në shëndetësi, pra kemi filluar monitorimin e ligjit të shëndetësisë. E kemi ftuar ministrin për raportim para komisionit, i kemi dhënë vërejtjet tona, të cilat kanë qenë edhe për marrëveshjen e kredisë së Kosovës me Austrinë -Unicredit Bank Austria AG, për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK, ku kemi pasur një ndikim mjaft të madh dhe kemi marrë përgjegjësi në mbikëqyrjen e kësaj marrëveshje.

Po ashtu, si Komision disa herë kemi shprehur shqetësimin për buxhetin e ministrisë. Po ashtu, i kemi dëgjuar edhe odat e profesionistëve shëndetësorë, ku kemi kërkuar nga ministri në bartjen e kompetencave dhe përmirësimin kushteve për funksionalizimin e odave.

Ali Berisha - Është fakt se ky komision ka provuar që të punojë në bazë të mandatit dhe fushëveprimit të tij si dhe brenda kapaciteteve që ka pasur. Mirëpo, ne si anëtarë të komisionit duhet të falënderojmë ish-kryetaren e komisionit doktoreshën Flora Brovina për angazhimet e saja në shumë aspekte. Besoj se është një pajtim i të gjithëve se sa i përket Ligjit për shërbimin mjekësor emergjent, ka pasur një angazhim të madh të komisionit, mirëpo në shumë aspekte tjera që janë trajtuar këtu në komision, ndikimet tona kanë qenë të vogla.

Kryetari - Në bazë të asaj që është paraqitur në raportin e punës si dhe në rezymenë në fund shoh se komisioni ka bërë një punë tepër të madhe dhe në këtë rast e falënderojmë kryetaren e Komisionit znj. Flora Brovina dhe anëtarët e komisionit për punën që e kanë bërë brenda këtij viti.

Pajtohem me diskutimet e juve, që deklaruat se shëndetësia asnjëherë s'ka qenë prioritet i Qeverisë. Kjo çështje edhe neve na ka brengosur vazhdimisht. Po ashtu, pasi kemi pranuar mandatin e deputetit kemi e vërejtur këtë gjë dhe gjatë shqyrtimit të buxhetit kemi vërejtur se tash buxheti është edhe për 1 (një) milion euro më i vogël.

Gjithashtu, në fund është shtyrë fillimi i zbatimit të sigurimeve shëndetësore, mirëpo, besoj se do të jemi bashkë si anëtarë të komisionit si në trajtimin e çështjeve dhe punëve, për të përmirësuar sektorin e shëndetësisë dhe çështjen sociale.

Kryetari, konstatoi se pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti vjetor i punës së Komisionit për vitin 2016.

5. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2017;

Kryetari: Mund të vazhdojmë me shqyrtimin e Planit të Punës së Komisionit për vitin 2017. Ju para vetes keni draft- planin që e ka përgatitur stafi mbështetës i Komisionit, duke u bazuar në programin legjislativ të miratuar nga Qeveria për vitin 2017, si dhe aktivitetet e tjera që kanë mbetur pa u përfunduar. Ne mund ta plotësojmë edhe me aktivitete të tjera nëse keni ndonjë propozim.

Shukrie Bytyçi - Falënderoj ish- kryetaren për punën dhe bashkëpunimi, por falënderoj edhe stafin për përgatitjen e draft- planit. Shëndetësia është prioritet i të gjithë anëtarëve të komisionit dhe në këtë komision nuk veprojmë si pozitë e opozitë. Në muajin janar kisha propozuar ta ftojme ministrin e shëndetësisë dhe drejtorin e SHSKUK-së, të raportojnë për mungesën e barnave të listës esenciale. Ministri ose duhet të ofrojë zgjidhje për problemet në shëndetësi ose të jep dorëheqje.

Kryetari - Pajtohem që ta ftojme ministrin dhe drejtorin në takim, edhe pse gjatë vitit 2016, të gjitha kompetencat e drejtorit të SHSKUK-së i ka marrë Ministria e Shëndetësisë, pra edhe buxhetin edhe furnizimin me barna . Ministrin t'a ftojme në raportim sepse ka shumë probleme në shëndetësi, ndërsa përgjegjësinë nuk po e merr askush.

Shukrie Bytyçi - Propozoj që gjatë këtij viti ta kemi prioritet edhe mbikëqyrjen e ligjeve, e sidomos mbikëqyrjen e Ligjit për aftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Besa Baftiu - Propozoj që ministrin ta ftojme që javën e ardhshme të raportojë sepse gjendja me furnizim me barna është e rëndë. Të shohim edhe në cilën fazë është zbatimi i marrëveshjes së kredisë me Austrinë sepse mendoj, që në atë drejtim nuk është punuar fare.

Besoj se plani i punës do të pësojë ndryshme në vazhdimësi, në bazë të nevojave të punës së Komisionit.

Ali Berisha - Pajtohem me raportimin e ministrit, sidomos sa i përket sigurimeve shëndetësore sepse ka pas një kokëfortësi nga ministri se sigurimet shëndetësore do të zbatohen nga 1 janari, por tash po shihet se nuk filluan të zbatohen.

Prioritet i planit të punës duhet të jetë edhe inicimi i ndryshimit të Ligjit për shëndetësi. Shëndetësia duhet ta ketë një hierarki të qartë të funksionimit. Çështje tjetër që duhet të përfshihet në planin e punës duhet të jetë hartimi i Ligjit për trajtimin e materialeve organike, pra komisioni duhet të iniciojë hartimin e Ligjit për materialet organike.

Fikrim Damka- Pajtohem se duhet ta ftojme ministrin të raportojë qoftë për agjendën që ai do ta zbatojë për vitin 2017, por edhe për çështjet tjera si sigurimet shëndetësore. Sa i përket furnizimit me barna përgjigja do të jetë se është hapur tenderi .

Rekomandimet që do të dalin nga monitorimi i Ligjit të shëndetësisë do jenë bazë për Ministrinë e Shëndetësisë ta ndryshojë Ligjin për shëndetësi. Nuk mendoj se ne si komision të procedojmë me ndryshimin e Ligjit për shëndetësi.

Sa i përket monitorimit të marrëveshjes së kredisë me Austrinë, do të monitorojmë në përputhje me vendimin e Kuvendit, ndërsa sa i përket shqyrtimit të raportit të shpenzimeve të ministrive përkatëse, kjo mund të jetë në kundërshtim me kompetencat e komisioneve tjera funksionale si Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Kjo duhet të koordinohet me komisionet tjera.

Fadil Beka- Plani i punës është mjaftë ambicioz dhe ka mjaftë punë, kështu si komision do të punojmë shumë në realizimin e tij, sot ta miratojmë dhe të vazhdojmë më tutje.

Ali Berisha- Iniciativat për hartim të ligjeve nuk duhet të vinë vetëm nga Qeveria por edhe nga ne e sidomos kur shohim se ka mungesë të legjislacionit në fushat e caktuara. Mendoj se ndryshimi i Ligjit për Shëndetësi është shumë vonë në tetor, duhet ne si Komision më herët të fillojmë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të shëndetësisë.

Edhe plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit të dëshmorëve duhet të ndryshohet nga ky Komision, pasi është në fushëveprimin e Komisionit. Edhe monitorimi i shpenzimeve të ministrive përkatëse duhet të shqyrtohet në Komisionin tonë.

Shukrie Bytyçi- Mendoj se Ligji për Dëshmorët duhet të trajtohet nga Komisioni, ngase mendoj se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut me këtë ligj. Ka një vit që familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve ju kanë ndalë pensionet , si p.sh. bashkëshortja e dëshmorit si mësuese nuk e merr pensionin e mësimdhënies, por vetëm pensionin e dëshmorit. Apo nëse është pensionist i moshës nuk e merr pensionin e moshës por vetëm pensionin e familjes së dëshmorit.

Kryetari konstatoi se pas diskutimeve, në lidhje me planin e punës për vitin 2017, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2017.

6. Të ndryshme;

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Nehat Baftiu